Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0787

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Isa Hasani - Kryetar,Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Gashi Ing" SH.P.K. & "Deshishku GB" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Zgjerimi i rrjetit te Kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, pusetave dhe shtratit te lumejve ne Qytet dhe Periferi"me nr. të prokurimit:"2023/642-23-849-5-1-1/B05-0003321", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Mitrovice, me datën 19.01.2024, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e Operatorit ekonomik "Gashi Ing" SH.P.K. & "Deshishku GB" SH.P.K. me numër protokolli; 787/2023, kundër "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" për aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit, pastrimi i kanalizimit, pusetave dhe shtratit te lumenjve në qytet dhe periferi" prokurimi: "2023/642-23-849-5-1-1/B05-0003321", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi Komunal Mitrovice.

2. Anulohet "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" i datës, 22.09.2023, për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, sipas nenit 31.4 dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 06.11.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Pretendimet ankimore te Operatorit Ekonomik Gashi Ing SHPK & Deshishku GB SHPK dhe përgjigjet e ekspertit shqyrtues raporti nr.787/2023, datës 06.11.2023.

Pretendimi nr.1.OE" Gashi Ing SHPK & Deshishku GB SHPK - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së.

Eksperti thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është te sigurojë mënyrë ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen. Ndër të tjera pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e nenin1 të LPP-së, shih pretendimin :*Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së, pasi na ka eliminuar neve edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kriteret e parapara dhe kemi qenë ofertues me çmim më te lirë* . Eksperti thekson se pretendimi i OE ankues qëndron pjesërisht, sepse pa u siguruar siç parashihet me ligj se OE ankues ka çmime jo normalisht të ulëta dhe të larta AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit ku OE ankues ishte ofertues me çmimin më të lirë.(sqarim ma në detale do ta gjeni te përgjigjeje lidhur me pretendimi nr.4. ne ketë raport).Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr.2 .OE ankues - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së.

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është te respektohet ekonomiciteti dhe efikasiteti ku te gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që te sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyre më ekonomike ,njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit .Gjithashtu eksperti sqaron neni 6 i LPP-së është përmendur vetëm sipërfaqësisht, ky nenë ka vetëm dy paragrafë dhe OE ankues nuk ka pasur asnjë pretendim konkret për asnjërin paragraf. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 3.OE, ankues - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së.

Eksperti thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit. Ndër tjera pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e parag.1 dhe paragr.6 të nenin7 të LPP-së,shihë pretendimin: *Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë edhe pas vendimit te OSHP-së AK ka gjetur arsye tjera për eliminimin e ofertës tonë* .

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së

aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Eksperti sqaron se pa u sqaruar plotësisht se tenderi -oferta ka ose jo çmime jo normalisht të ulëta dhe jo normalisht te larta duke bërë ndonjë krahasim që lejohet ligjërisht oferta nuk mundë te eliminohet sikur ne rastin konkret, sa i përket paragrafit 6 te nenit 7 i njëjti pretendim nuk qëndron sepse AK nuk ka shpallur asnjë ofertues fitues por e ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr. 4.OE, ankues pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së.

Eksperti thekson se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Ri-vlerësimit .OE ankues ndër të tjera pretendon se vlerësimi nuk është bërë komforë nenit 59 të LPP-së , sepse vendimi është nxjerrë në shkelje të dispozitave të lartë cekura, madje ky vendim përveç që është diskriminues është edhe skandaloz, për faktin se është thirrur në Rregulloren për tenderët Jo-Normalisht të ulët e cila është e shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP) me datë: 01.11.2022 (Shih argumentin).Neni 102-Dispcziiat e shfuqizimit. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen:

1. A0.1 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik — të datës 01.02.2021,

2. Udhëzimi Administrative Nr; 1/2019,

3. B57 Rregullat për tenderët Jo-Normalisht te ulët 71,

4. F03 Rregullat për parashtrimin e ankesave,

5. Rregullore Nr. 2/2017 për procedurat e dhënies dhe revokimit te certifikatës profesionale për prokurimin publik,

6. 1159 Rregullat për Shërbime te veçanta (Konsulentët/Kontraktorët individual) (18.11.2020)

Eksperti konstaton se qëndron pretendimi i OE ankues sepse Rregullorja për tenderët Jo-Normalisht të ulët , është e shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP),mirëpo edhe sikur të ishte në fuqi e njëjta rregullore për rastin konkret e njëjta nuk do mundë të aplikohej sepse kemi te bëjmë me çmime me Poentim.

Shih nenin 27.13 dhe 27.15 të Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP)

7.13 Gjatë përdorimit të kriterit çmimi më i ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuar bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.

27.15 Nuk lejohet krahasimi i çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën dhe të konvertohen vlerat e llogaritura në pikë, mandej të peshohen pikët pasi që në ketë mënyre pikët më të larta të poentuar jo domosdoshmërish do të rezultojnë në çmimin më të ulët.

AK ka bërë krahasimin e ofertave njëra me tjetrën duke e përdor-aplikuar ,,Rregullorja për tenderët Jo-Normalisht të ulëte cila edhe në atë kohë ishte e shfuqizuar edhe pse kur kemi te bëjmë me çmime me poentim e njëjta rregullore nuk aplikohej edhe para shfuqizimit të saj.

Eksperti sqaron se AK nuk ka përdor metoda te lejuara gjatë procesit te Rivlerësimit dhe nuk ka arritur të bëjë vlerësim se a janë apo jo ofertat me çmime jo normalisht te ulëta apo te larta sepse nuk ka ndonjë dëshmi se ka bërë hulumtim te tregut ,nuk ka ndonjë dëshmi se ka bërë ndonjë krahasim me ndonjë kontratë paraprakë dhe nuk ka ndonjë dëshmi se ka bërë ndonjë hulumtim tjetër të lejuar. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar .

Pretendimi nr. 5.OEankues - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar nenin 60 të LPP-së.

Eksperti thekson se qellim i nenit 60 është vendosja e kriterit dhe se kriter në DT, ishte të shpërblehet me kontratë Ofertuesi i përgjegjëshëm me çmimin më të ulët të peshuar. Eksperti sqaron se pretendimi është i pa bazuar sepse me kontratë nuk është shpërblyer asnjë Operator Ekonomik që ishte me çmim më te lartë se sa oferta e OE ankues. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi nr.6 .OE ankues - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar par 43.5 dhe 43.7 te nenin 43 të Rregullores nr; 01/2022 për prokurim publik(RRPP)

Eksperti sqaron se ky nenë ka për qellim te udhëzoj AK se ne cilat raste parashihet te bëhet ndërprerja e procedurave te prokurimit. Eksperti sqaron se ky pretendim është pjesërisht i bazuar sepse siç u sqarua ne pretendimin nr. 4 aktiviteti u anulua pa u siguruar se ishte apo jo ofertë me çmime jo normalisht të ulëta dhe te larta ,me ketë dispozitë parashihen nga pika a. deri te pika k. se per cilat raste procedura e prokurimit anulohet për ndonjërën arsye pas hapjes; Nëse vërtetohet se çmimet janë jo normalisht te ulëta dhe te larta anulimi do gjente bazën ligjore , ku decidivisht thuhet te pika b. asnjeri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm. Andaj Eksperti konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr.7 .OE ankues - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Mitrovicë nuk e ka respektuar paragrafin 97.1 nen par(d) ,(e),(h),(o). te nenin 97 të Rregullores nr; 01/2022 për prokurim publik(RRPP).

Eksperti sqaron se ky nenë ka për qellim te udhëzoj AK se cilat janë shkelje te renda sipas pikave te OE ankues: mosrespektimi i parimeve te prokurimit, trajtimit te kërkesave për rishqyrtim ,mosrespektim i vendimit te OSHP-së ,sjellje te gabuar dhe jo profesionale. Eksperti sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues lidhur me pretendimet sepse janë zbatuar procedurat mirëpo mënyra e pergjigjëjeve dhe mënyra e te shkruarit është relative andaj në rastin konkret nuk kemi te bëjmë me shkelje të renda nga Zyrtari i Prokurimit edhe vendimi i OSHP-së ishte respektuar nga ana e AK-së. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Rekomandimi i Ekspertit shqyrtues.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Gashi Ing" SH.P.K. & "Deshishku GB" SH.P.K. të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimit mbi vendimin AK dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Raportin e ekspertit e kane pranuar palët, Operatori Ekonomik; "Në parim pajtohemi me mendimin e ekspertit. Por nuk pajtohemi me përgjigjen nr.: 3 të Ekspertit shqyrtues - Ne konsiderojmë që nga momentin kur kemi dorëzuar ofertën me datë 03.03.2023, ka pasur përpjekje nga Autoriteti Kontraktues në vazhdimësi, të na eliminojnë nga kjo procedurë e prokurimit, dhe të shpërblej - ri shpërblej me çdo kusht me kontratë OE: Eurondertimi SH.P.K. - të gjitha këto pretendime i gjeni në ankesën tonë të datës: 12.10.2023 të dorëzuar në OSHP".

Autoriteti kontraktues:" I nderuar Panel i OSHP-së dhe i nderuari Ekspert ne si AK ju rekomandojmë ta shikoni vendimin e Panelit te OSHP-së me nr 2023/0417 ku për te njëjtat qmime Jo normalisht te Ulta dhe Jo Normalisht te larta ju si Panel e keni refuzuar Ankesën si te pa bazuar dhe i keni konfiskua tarifën e ankesës O.E. për arsye te njëjta te cilat janë edhe në procedurën në fjalë për te njëjtat arsye, nuk kemi

kurrfarë nevoje te argumentohen qmimet e O.E. sipas ekspertit pasi shihen qartë se janë qmime shumë te ulta për shumë pozicione dhe shumë te larta për shumë pozicione dhe ne nuk e kemi eliminua një O.E. por disa O.E. kurse tjerët nuk i plotësojnë kushtet, vetëm O.E. DESHISHKU ka parashtruar ankesë kurse ne i kemi eliminua te gjithë dhe kemi anuluar procedurën, kështu që i propozoi Panelit te nderuar të sjellë vendim për Anulimin e procedurës në fjalë".

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik,Njoftimin për Kontratë, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për të shpërblyer me kontrate OE për aktivitetin e prokurimit, Raportin e Vlerësimit të Komisionit Vlerësuese të AK, Vendimin e Autoritet Kontraktues lidhur me Kërkesën për rishqyrtim. \Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë konstatuar si të bazuara.

Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga AK, por që vlerësohet se me kthimin e këtij aktiviteti të prokurimit në Rivlerësim AK do bëjë Ekzaminimin, vlerësimin dhe

krahasimin e tenderëve konform Nenit 59 të LPP-së, si dhe ti trajtoj të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe të veprojë në mënyrë transparente, si dhe të veproj konform rekomandimeve te lartcekura në raportin e ekspertizës si dhe të veproj në tërsi me dispozitat ligjore të LPP-së.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: "Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankesës së Operatorit ekonomik, vendos ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga OE ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**
- OE - **DESHISHKU GB SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: